




**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY**

PSH. nr. 228/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina – Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “DWH-Albania”SH.P.K. Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me instrument GPS” me nr. të prokurimit: 632-19-2948-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjakovë, më datë: 17.06.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “DWH-Albania”SH.P.K. Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me instrument GPS” me nr. të prokurimit: 632-19-2948-1-3-6, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjakovë.

II. OBLIGOHET, autoriteti kontraktues /Komuna e Gjakovës / ti bëjë ndryshimet në dosje të tenderit konform LPP-së dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues – teknik, dhe të veproj konform nenit 53.7 të LPP-së, lidhur me aktivitetin të prokurimit “Furnizim me instrument GPS” me nr. të prokurimit: 632-19-2948-1-3-6.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “DWH-Albania”SH.P.K. Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Data e njoftimit për kontratë: 09.05.2019

Lloji i procedurës së aplikuar: Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: Kontratë për furnizim/ vlerë e mesme

Vlera e parashikuar e kontratës: 9,000.00 €

Kriteri për dhënie të kontratës (N.52) tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave: 17.05.2019

Data e hapjes së ofertave : 17.05.2019

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave : 09.01.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim: 13.05.2019

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim : 16.01.2019

Me datën: 21.05.2019 OE “DWH-Albania”SH.P.K. Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me instrument GPS” me nr. të prokurimit: 632-19-2948-1-3-6 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Gjakovë, Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore :

- Neni 1 – pika 1, 2,3 i LPP-së
- Neni 7 – pika 1, 2, 3, 5 dhe 6 të LPP-së
- Neni 28 – pika 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 të LPP-së

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 30.05.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues, në raportin e dt: 10.06.2019 konstaton dhe sqaron si në vijim:

Fillimisht Eksperti teknik/shqyrtues ju sqaron se pretendimet ankimore të OE ankues janë parashtruar në lidhje me kriteret e përzgjedhjes të cilat kanë të bëjnë me specifikim teknik të përshkruar në dosjes e tenderit.

Përgjigje në Pretendimin nr. 1

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK. është bazuar në produkt të prodhuesit Topcon/Sokkia dhe ka selektuar në datasheet-in e këtij prodhuesi ato specifika.

Eksperti teknik thekson se pasi OE ankues është i bindur se AK e ka selektuar datasheet-in e këtij prodhuesi Topcon/Sokkia atëherë pse nuk e ka përmendur se për cilin lloj të GPS behet fjale që të mund të krahasojmë. Pra pasi OE ankues nuk ka paraqitur ndonjë fakt atëherë nuk qëndron ky pretendim. Eksperti teknik vlerëson sespecifikacioni i këtij datasheet i plotësojnë edhe produktet tjera siç janë: stonex, Hi-target.

Përgjigje në Pretendimin për specifikimet teknike nr. 2

Lidhur me pretendimin e OE ankues, të kërkesa për windows që nuk është kërkesë direkte për performancën dhe funksionalitetin e GPS.

Eksperti teknik vlerëson se është e drejtë që AK të caktojë çfarëdo sistemi kompjuterik që mendon se është me e sigurt dhe me e përshtatshme gjatë punës. Ndërsa lidhur me pretendimin e OE ankues, se windows 10 përjashton 99% të prodhuesve, Eksperti teknik vlerëson se qëndron pretendimi sepse kërkesa direkte për windows 10 është e ekzagjeruar pasi nuk ka ndonjë dallim të madh me windows 7 ose 8.

Përgjigje në Pretendimin për specifikimet teknike nr. 3

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se IP-67 në GPS dhe IP-68 në Windows përbën non-sens në gjeodezi.

Eksperti teknik thekson se është e vërtetë që përbën non-sens në gjeodezi por përbën sens në aspektin e ruajtjes së GPS dhe terminalit nga kushtet e ndryshme atmosferike dhe për këtë arsye nuk qëndron ky pretendim.

Përgjigje në Pretendimin për specifikimet teknike nr. 4

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se memorie e lartë e brendshme kur zhvillimi shkon drejt memorieve të lëvizshme që janë me fleksibile dhe me të sigurta.

Eksperti teknik vlerëson se nuk qëndron pretendimi pasi është vërejtur çdo vit nga prodhuesit që është e nevojshme memoria e larte e brendshme dhe për këtë arsye çdo telefon, pc, laptop apo edhe ne këtë rast terminal i ri po del gjithnjë me memorie sa me të lartë.

Mendimi i ekspertit teknik:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesën e OE ankues të aprovohet pjesërisht si të bazuar (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet ankimor nr. 2), njëherit rekomandoj që ky aktivitet i prokurimit të eliminoj kriterin e kërkuar ne lidhje me Windows 10, pastaj Autoriteti kontraktues mundet te vazhdoj më tutje.

Autoriteti Kontraktues – Komuna Gjakovë, me datë: 12.06.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues me datë: 11.06.2019 me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 17.06.2019 pa praninë e palëve pasi që të njëjtit janë thirrur në mënyrë të rregullt përmes email por të njëjtit nuk kanë prezantuar në seancë e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të OSHP-së dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha provave dhe shkresave të lëndës, raportit të ekspertit shqyrtues teknik, analizimit të dokumentacionit të lëndës, konstatoj se pretendimi i OE ankues, se AK e ka selektuar datasheet-in e këtij prodhuesi Topcon/Sokkia është i paqëndrueshëm sepse po të ishte i sigurt për këtë OE ankues ka qenë dashur ta përmend se për cilin lloj të GPS behet fjale që të mund ti krahasojmë. Pra, pasi OE ankues nuk ka paraqitur ndonjë fakt atëherë nuk qëndron ky pretendim. Sipas raportit të ekspertizës paneli shqyrtues konstaton se specifikacionin i këtij datasheet i plotësojnë edhe produktet tjera siç janë: Stonex, Hi-target.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, te kërkesa për windows që nuk është kërkesë direkte për performancën dhe funksionalitetin e GPS paneli shqyrtues vlerëson se është e drejte që AK te caktojë çfarëdo sistemi kompjuterik që mendon se është me e sigurt dhe me e përshtatshme gjate punës. Ndërsa

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se windows 10 përjashton 99% të prodhuesve, paneli vlerëson se qëndron pretendimi sepse kërkesa direkte për windows 10 është e ekzagjeruar pasi nuk ka ndonjë dallim te madh me windows 7 ose 8.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se IP-67 ne GPS dhe IP-68 ne Windows përbën non-sens ne gjeodezi, paneli shqyrtues duke u bazuar edhe ne raportin e ekspertizës thekson se është e vërtetë qe përbën non-sens ne gjeodezi por përbën sens ne aspektin e ruajtjes se GPS dhe terminalit nga kushtet e ndryshme atmosferike dhe për këtë arsye nuk qëndron ky pretendim.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se memorie e larte e brendshme kur zhvillimi shkon drejt memorieve te lëvizshme qe janë me fleksibile dhe me te sigurta, paneli shqyrtues vlerëson se nuk qëndron pretendimi pasi është vërejtur çdo vit nga prodhuesit qe është e nevojshme memoria e larte e brendshme dhe për këtë arsye çdo telefon, pc, llaptop apo edhe ne këtë rast terminal i ri po del gjithnjë me memorie sa me të lartë.

Paneli shqyrtues pas analizimit dhe vlerësimit të raportit të ekspertizës konstaton se autoriteti kontraktues Komuna e Gjakovës në rastin konkret duhet të veproj konform nenit 57. 3 të LPP-së dhe ti bëjë ndryshimet në dosje të tenderit konform LPP-së dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues – teknik te dhëna ne raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK - "Komuna Gjakovë- Gjakovë,
- 1x1 OE - "DWH-Albania"SH.P.K. Prishtinë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
z. Blendi Dina

